



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Beqir Kalludra, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Ahmeti, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit M.M. nga fshati ..., Komuna e Skenderajt, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 3227/2018, më datën 17 shtator 2020, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.528/2020, i datës 14 shtator 2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 21 janar 2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e papabuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjyqimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr. 528/2020, i datës 17 shtator 2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjyqimin e lartcekur, përkatësisht me aktgjyqimin e ankimuar, të pandehurin M.M. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK dhe ndaj të njëjtit për shkak të kësaj vepre penale është shqiptuar dënim me kusht, në atë mënyrë që ndaj të pandehurit është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) vjetëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen veprën tjetër penale.

Është detyruar i pandehuri M.M., që t'i paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 € (njëzet Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë)

ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit mbi dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta aprovoj ankesën dhe ta anuloj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që kjo çështje penale t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim ose të ndryshohet aktgjykimin i ankimuar, ashtu që ndaj të pandehurit të shqiptohet dënim më i madh, në përputhje me pretendimet e ankesës.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.1110 /2020, të datës 17 nëntor 2020, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ashtu që të ndryshohet aktgjykimin i ankimuar dhe ndaj të pandehurit të shqiptohet një dënim më i ashpër.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë theksohet se gjykata e shkallës së parë edhe përkundër se e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se në procedurë ka pasur shkelje të konsiderueshme të procedurës penale, e njëjta në bazë të asaj gjendje të vërtetuar faktike nuk e ka matur saktë dënimin të cilin e ka shqiptuar ndaj të pandehurit për veprat penale të kryera. Po ashtu, në ankesë theksohet se i pandehuri ka kryer këtë vepër penale me paramendim, për përfitim të pensionit në bazë të pjesëmarrjes në luftë, edhe pse ishte në dijeni se nuk ka qenë pjesëtar në luftë dhe si i tillë nuk ishte i regjistruar si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të cilëve u takonte pensioni. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë nuk e ka pasur parasysh edhe faktin se pensionet janë paguar nga fondet publike, andaj edhe është dashur që një gjë e tillë të merret për bazë si rrethanë rënduese, kështu që edhe do të mund të arrihej qëllimi i dënimit. Andaj duke u bazuar në këto që u thanë, Prokuroria Themelore në Mitrovicë i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës si më lartë.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar, në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se:

- ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimin i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të pandehurit M.M..

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e lartcekura të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë janë të pabazuara. Kolegji penal i

Gjykatës së Apelit të Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë nuk është paraqitur ndonjë rrethanë tjetër të veçantë që nuk është vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e cila edhe në lidhje me rrethanat tjera do ta justifikonte shqiptimin e ndonjë dënimi më të ashpër. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të pandehurit M.M. kishte vlerësuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, e që si rezultat i kësaj është kontribuar edhe në vërtetimin e gjendjes faktike, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, se i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, si dhe faktin se i njëjti është person i moshuar, ndërsa nuk janë gjetur rrethana rënduese. Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave që i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, si dhe të rrethanave tjera të rastit konkret, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konsideron që dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit M.M. është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën dhe me mënyrën e kryerjes së veprës penale, me sjelljet e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës penale, me gjendjen ekonomike të tij, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale. Gjithashtu, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti i Përgjithshëm

PA1.nr.1097/2020, më datën 21 janar 2021

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Kryetare e kolegjit,
Shqipe Qerimi

Beqir Kalludra